



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 22.01.2020

Dokument parlamentar

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË ANEKSIN VI TË KONVENTËS NDËRKOMBËTARE DETARE “PËR PARANDALIMIN E NDOTJEVE NGA ANIJET, 1973”, TË NDRYSHUAR ME PROTOKOLLIN E VITIT 1978 (MARPOL 73/78)”

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 22.01.2020, mori në shqyrtim projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aneksin VI të konventës ndërkombëtare detare “Për parandalimin e ndotjeve nga anijet, 1973”, të ndryshuar me protokollin e vitit 1978 (MARPOL 73/78)”.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin z. Edmond Leka.

Në mbledhjen e komisionit, për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të komisionit, ishte i pranishëm zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Artan Shkreli.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 i saj.

II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Projektligji synon të plotësojë kuadrin ligjor në fushën e mbrojtjes së mjedisit detar nga ndotjet nga anijet.

Një nga konventat më të rëndësishme në fushën e transportit detar është dhe konventa ndërkombëtare detare për parandalimin e ndotjeve nga anijet, e vitit 1973/1978 (MARPOL 73/78).

Republika e Shqipërisë, me ligjin nr.9594, datë 27.7.2006, aderoi në këtë konventë ndërkombëtare detare së bashku me pesë anekset e saj.

Marrëveshja që propozohet për aderim ka si objekt përmirësimin dhe mirëpërcaktimin e detyrave të institucioneve zbatuese, si dhe të sigurojë standarde të njëjta për të gjitha shtetet anëtare lidhur me kërkesat për sigurinë e parandalimit të ndotjes së ajrit nga anijet.

Aktualisht, anijet me flamur shqiptar janë të detyruara të mbajnë certifikatat e përmendura në aneksin VI, me anën e të cilave garantojnë se i plotësojnë të gjitha kushtet dhe kriteret për mbrojtjen e ajrit, pasi konventa i detyron të gjitha anijet që ti plotësojnë këto kushte dhe të mbajnë këto certifikata. Në rastet kur anijet prekin porte detare të një shteti anëtar të aneksit VI, administrata detare e këtij porti do të inspektojë mbajtjen e këtyre certifikatave edhe nga anijet që mbajnë flamurin e një shteti jo anëtar. Mosekzistenca e këtyre certifikatave në bordin e anijes do të sjellë si pasojë moslejimin e lundrimit të anijeve, si dhe do t'i detyrojë pronarët e anijeve që të mirëmbajnë anijet, duke i plotësuar të gjitha kushtet e nevojshme teknike sipas kërkesave të kërkuara nga Organizata Ndërkombëtare Detare (IMO) dhe Bashkimi Evropian (EU).

Aneksi VI, miratuar nga Organizata Ndërkombëtare Detare (IMO), parashikon rregulla për mbrojtjen e ajrit nga emetimi i gazeve nga djegia e karburanteve nga anijet.

Ndryshimet kryesore në këtë aneks kanë si qëllim uljen progresive në rang global të emetimeve dhe grimcave të SO_x, NO_x dhe futjen e zonave të kontrollit të emetimeve (ECA) për të zvogëluar emetimet e ndotësve të ajrit.

Masat e rishikuara pritet të kenë një ndikim domethënës të dobishëm në mjedisin atmosferik dhe shëndetin e njeriut, veçanërisht për ata njerëz që jetojnë në qytetet portuale dhe komunitetet bregdetare.

Miratimi i këtij projektligji nuk do të sjellë efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

III. ÇËSHTJE TË DISKUTUARA NË KOMISION DHE PROPOZIME PËR NDRYSHIME

Pas prezantimit të projektligjit nga zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Artan Shkreli, relatori i projektligjit, z. Edmond Leka theksoi rëndësinë që ka miratimi i kësaj nisme.

Gjatë diskutimit nen për nen, z. Leka propozoi ndryshime në nenin 1 të projektligjit, konkretisht, që të hiqet fjala “*aderon*” dhe togfjalëshi “*duke përfshirë dhe rezolutat MEPC.271(69) dhe MEPC.278(70)*”.

Përfaqësuesit e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë argumentuan se titulli i aneksit VI të konventës ndërkombëtare detare, i përcaktuar në këtë nen, bazohet në përkthimin zyrtar të titullit të tekstit të konsoliduar të aneksit VI të MARPOL.

Komisioni, pasi dëgjoi argumentat e përfaqësuesve të Ministrisë, miratoi një ndryshim në nenin 1 të projektligjit, të cilin ia përcjell komisionit përgjegjës si më poshtë vijon:

- *Në nenin 1 të projektligjit, të hiqet fjala “aderon”.*

IV. PËRFUNDIM

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

Në aspektin ligjor, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi atë me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

RELATOR

EDMOND LEKA

KRYETAR

ULSI MANJA